



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1418 Prot.

Tiranë, më datë 13.09.2021

VENDIM
Nr. 575, datë 23.09.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.09.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e *Relacioni të verifikimit në terren në kuadër të gjetjeve rastësore të zbuluara pranë fshatit Kthellë, të Mirditës, pas njoftimit të banorëve të zonës*, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK-së;
2. Të realizohet një vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor, përreth zonës që është konstatuar gjetja arkeologjike nga DSHA;
3. Të realizohet gjërmim shpëtimi arkeologjik në zonat ku është zbuluar objekti i qeramikës dhe i zonës ku janë zbuluar gjetjet rastësore, sipas “Rregullores mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut, kriteret e gjërimit, dokumentimit dhe arkivimit të dhënave dhe materialeve arkeologjike, kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private”, miratuar me Vendimin Nr.2, datë 30.01.2009 të KKA, nga DSHA;
4. Rezultatet e gjërimit arkeologjik të shpëtimit të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
5. Të bëhet regjistrimi i objektit pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

